



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III
Sesioni pranveror

Seanca plenare e Kuvendit
P- 105
Prishtinë, më 15 prill 2010

PROCESVERBAL

**I SEANCËS PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS, TË
MBAJTUR MË 15 PRILL 2010**

Seancën e kryesoi **Jakup KRASNIQI**, kryetari i Kuvendit, ndërsa i ndihmoi **Naim Maloku**, anëtar i Kryesisë së Kuvendit.

Kryetari konstatoi se në sallë janë të pranishëm 85 deputetë.

Në fillim të seancës, për fjalë u paraqitën deputetët: Adem Hajdaraj dhe Gjylnaze Sylja.

Deputeti **Adem Hajdaraj** shtroi çështjen e profesorëve universitarë të cilët kanë kaluar moshën 65 vjeçare, e të cilët sipas një vendimi të Qeverisë së Republikës së Kosovës, mund të punojnë në procesin mësimor edhe pas kësaj moshe. Ai kërkoi që kjo çështje të precizohet në mënyrë të duhur, shikuar nga aspekti i rregullativës ligjore.

Deputetja **Gjylnaze Sylja** shprehu shqetësimin e saj lidhur me mungesën e disa ligjeve bazike, siç janë: Ligji për Punë, Ligji për Sigurimet Shëndetësore etj. Ajo kërkoi nga Qeveria që këto Projektligje sa më parë të procedohen në Kuvend.

Kryetari i njoftoi deputetët se Grupi Parlamentar i LDK-së ka njoftuar se kryetar i këtij grupi, është deputeti Ismet Beqiri.

Kryetari i njoftoi deputetët se Kryesia e Kuvendit, në marrëveshje me kryetarët e grupeve parlamentare, ka përgatitur dhe Kuvendit ia ka paraqitur rendin e ditës për seancën e sotme plenare.

Kuvendi në vazhdim i zhvilloi punimet me këtë

R e n d d i t e

1. Miratimi i procesverbalit të seancës së mëparshme
2. Koha për pyetje parlamentare,
3. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës,
4. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për ujitjen e tokave bujqësore,
5. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për gjykatat,
6. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për grevat,
7. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për energjinë elektrike,
8. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për shërbimet postare,
9. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për Mërgatën e Kosovës,
10. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për tatimin mbi vlerën e shtuar,
11. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për zbatimin e sanksioneve ndërkombëtare,
12. Shqyrtimi i Propozimit të Qeverisë së Kosovës për emërimin drejtorit dhe të zëvendës drejtorit të Zyrës së Rregullatorit për Ujësjiellës dhe Mbeturina,
13. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për formimin e Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e anëtarëve të Këshillit të Komisionit të Pavarur për Media, dhe
14. Propozimet e Grupit Parlamentar të LDK-së dhe të Grupit Parlamentar të AAK-së për zëvendësimin e anëtarëve në komisionet parlamentare të Kuvendit.

1. Miratimi i Procesverbalit të seancës plenare, të mbajtur më 1 prill 2010

Procesverbali i seancës plenare të mbajtur më 1 prill 2010, u miratua pa vërejtje.

2. Koha për pyetje parlamentare

Deputeti **Riza Smaka** parashtroi pyetje për ministrin për ekonomi dhe financa, Ahmet Shala lidhur me rëndësinë e auditimit të brendshëm

Ministri Shala ju përgjigj pyetjes së deputetit Smaka.

Deputetja Drita Maliqi parashtroi pyetje për ministrin e punës dhe mirëqenies sociale, Nenad Rashiq lidhur me mungesën e ligjit të punës.

Ministri Rashiq ju përgjigj pyetjes së deputetes Maliqi.

Deputetja Qamile Morina parashtroi pyetje për ministrin e arsimit Enver Hoxhaj lidhur me projektin për ndërtimin e shkollës në veri të Mitrovicës.

Ministri Hoxhaj ju përgjigj pyetjes së deputetes Morina.

Deputeti **Bujar Dugolli** parashtroi pyetje për ministrin e tregtisë dhe industrisë, Lutfi Zharku lidhur me hapat që ka ndërmarrë Ministria që Kosova të jetë anëtare e barabartë e Organizatës Botërore të Tregtisë.

Ministri Zharku ju përgjigj pyetjes së deputetit Dugolli.

Deputetja Myrvete Pantina parashtroi pyetje për ministrin për ekonomi dhe financa, Ahmet Shala lidhur me obligimet tatimore që i kanë bizneset Kosovare ndaj shtetit.

Ministri Shala ju përgjigj pyetjes së deputetes Pantina.

Deputeti Haset Cakolli parashtroi pyetje për kryeministrin, Hashim Thaqi, lidhur me funksionalizimin e Organit për shpronësim.

Kryeministri Thaqi ju përgjigj pyetjes së deputetit Cakolli.

Deputeti **Arsim Rexhepi** parashtroi pyetje për ministrin për ekonomi dhe financa, Ahmet Shala lidhur me firmat që kanë mbetur mbrapa me kryerjen e obligimeve ndaj shtetit.

Ministri Shala ju përgjigj pyetjes së deputetit Rexhepi.

Deputeti Abdyl Ymeri parashtroi pyetje për ministrin e mjedisit, ambientit, Mahir Yagcilar lidhur me ndotjen e ambientit në zonën e Feronikelit në Drenas.

Ministri Yagcilar ju përgjigj pyetjes së deputetit Ymeri.

Deputeti Naim Rustemi parashtroi pyetje për ministrin e shëndetësisë Bujar Bukoshi lidhur me ndërtimet private brenda hapësirës së QKUK-së.

Ministri Bukoshi ju përgjigj pyetjes së deputetit Rustemi.

Deputeti Nait Hasani parashtroi pyetje për kryeministrin, Hashim Thaqi, lidhur me guvernatorin e Bankës Qendrore, Hashim Rexhepi.

Ministri Ahmet Shala ju përgjigj pyetjes së deputetit Hasani.

Deputeti Enis Kervan parashtroi pyetje për ministren e administratës publike, Edita Tahiri lidhur me kremtimin e ditëve përkujtimore të komuniteteve

Ministrja Tahiri ju përgjigj pyetjes së deputetit Kervan.

3. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës

Kryesuesi ftoi ministren e Administratës Publike që në emër të Qeverisë ta prezantojë Projektligjin.

Edita Tahiri tha se ky Projektligj ka për qëllim përcaktimin e kornizës ligjore për administratën shtetërore dhe si i tillë ofron mundësi të mira për reformat në administratën publike. Nevoja për këtë Projektligj ka qenë mjaft e madhe pasi që me te përmbushet pakoja e Projektligjeve për administratën publike, duke pasur parasysh faktin se Projektligji për Qeverinë, Projektligji për shërbyesit civilë dhe ai për pagat e shërbyesve civilë, janë në procedurë parlamentare, tha ajo.

Në vazhdim tha se Projektligji përkufizon strukturën e organeve shtetërore, pozitën dhe strukturën organizative etj. Ajo tha se Projektligji ka gjithsejtë shtatë kapituj me 59 nene dhe më tej dha një pasqyrë për përmbajtjen e secilit kapitull, veç e veç.

Ajo në fund i ftoi deputetët për miratim në parim të Projektligjit për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës.

Kryesuesi hapi debatin për shqyrtimin, në parim, të Projektligjit për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë projektligj dhanë këta deputetë: në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, Bahri Hyseni, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Ismet Beqiri, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Gjylnaze Sylja, në emër të Grupit Parlamentar të AKR-së, Riza Smaka, në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së, Lulëzim Zeneli, në emër të Grupit Parlamentar “7+” Enis Kervan, në emër të Grupit Parlamentar SLS, Petar Miletiç ndërsa në emër të Grupit Parlamentar për Integritet, Vlladimir Todoroviç, si dhe deputetët: Naim Rustemi, Driton Tali, Teuta Hadri, Arsim Bajrami, Zylfije Hundozi, Armend Zemaj, Naser Rugova, Donika Kadaj-Bujupi, Berim Ramosaj dhe Edita Tahiri, që janë dhënë në transkript, i cili është pjesë përbërëse e këtij procesverbali.

Pas këtyre diskutimeve, kryesuesi e hodhi në votim miratimin e këtij projektligji.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----30,
Kundër-----28,
Abstenime-----7.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi me shumicë votash e miratoi Projektligjin për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës.

Kuvendi ngarkoi Komisionin për Administratë Publike, Pushtet Lokal dhe Media si komision funksional dhe raportues, Komisionin për Legjislacion dhe Gjyqësi, Komisionin për Buxhet dhe Financa, Komisionin për Komunitete dhe Komisionin për Integritet Evropiane që ta shqyrtojnë këtë projektligj brenda dy muajve dhe Kuvendit t’ia paraqesin raportet me rekomandime.

4. Shqyrtimi i parë Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për ujitjen e tokave bujqësore

Kryesuesi ftoi ministrin e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural që në emër të Qeverisë ta prezantojë Projektligjin.

Blerand Stavileci në fillim tha se për shkak të mangësive që ka Ligji në fuqi, ka lindur nevoja për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për ujitjen e tokave bujqësore, në mënyrë që ai të jetë në harmoni me ligjet e Bashkimit Evropian.

Në vazhdim tha se qëllimi i këtij Projektligji qëndron në rëndësinë e zhvillimit ekonomik, në ujitjen dhe mbrojtjen e resurseve bujqësore, me interes të përgjithshëm, pastaj përcakton themelimin e subjekteve të cilat ofrojnë shërbime për ujitjen e tokave bujqësore.

Ai më tej tha se në përpilimin e këtij Projektligji kemi shfrytëzuar përvojat nga shtetet e ndryshme si nga Gjermania, Sllovenia, Italia etj, poashtu janë marrë parasysh edhe rekomandimet e Agjencionit për koordinim dhe zhvillim për integritet evropian.

Ai në fund i ftoi deputetët për miratim në parim të Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për ujitjen e tokave bujqësore.

Kryesuesi hapi debatin për shqyrtimin, në parim, të Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për ujitjen e tokave bujqësore.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë projektligj dhanë këta deputetë: në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, Elheme Hetemi, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Myrvete Pantina, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Naim Maloku, në emër të Grupit Parlamentar të AKR-së, Hestet Cakolli, në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së, Naser Rugova, ndërsa në emër të Grupit Parlamentar “7+” Zylfi Merxha, si dhe deputetët: Luljeta Shehu dhe Gjylnaze Sylja, që janë dhënë në transkript, i cili është pjesë përbërëse e këtij procesverballi.

Pas këtyre diskutimeve, kryesuesi e hodhi në votim miratimin e këtij projektligji.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----66,

Kundër-----2,

Abstenime-----3.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi me shumicë votash e miratoi Ligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për ujitjen e tokave bujqësore.

Kuvendi ngarkoi Komisionin për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural dhe Planifikim Hapësinor, si komision funksional dhe raportues, Komisionin për Legjislacion dhe Gjyqësi, Komisionin për Buxhet dhe Financa, Komisionin për Komunitete dhe Komisionin për Integritet Evropian që ta shqyrtojnë këtë projektligj brenda dy muajve dhe Kuvendit t’ia paraqesin raportet me rekomandime.

5. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për gjykatat

Kryesuesi ftoi ministrin e Drejtësisë që në emër të Qeverisë ta prezantojë Projektligjin.

Haki Demolli në fillim tha se ky Projektligj është rezultat i punës për kompletimin e infrastrukturës ligjore, përmes të cilit synohet të bëhet organizimi i ri i gjykatave në Republikën e Kosovës.

Në vazhdim tha se ky Projektligj parasheh rregullimin e fushës së gjyqësorit në harmoni me standardet ndërkombëtare. Në të ardhmen, tha ministri, sipas këtij Projektligji do të kemi tri nivele të gjykatave: 1. Gjykata themelore, 2. Gjykata e apelit dhe 3. Gjykata Supreme, si institucion i fundit i gjykatave të rregullta në Republikën e Kosovës.

Më tej ai potencoi se pas hyrjes në fuqi pritet që gjyqësori të funksionojë në mënyrë më efikase kurse interesi i veçantë qëndron në faktin sepse është i bazuar në Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe ligjeve ndërkombëtare të pranuar nga kjo Kushtetutë.

Në fund ai i ftoi deputetët për miratim në parim të Projektligjit për gjykatat.

Kryesuesi hapi debatin për shqyrtimin, në parim, të Projektligjit për gjykatat.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë projektligj dhanë këta deputetë: në emër të Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi, Bahri Hyseni, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, Ramadan Gashi, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Ismet Beqiri, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Bajram Kosumi, në emër të Grupit Parlamentar të AKR-së, Suzana Novoberdaliu, në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së, Besa Gaxherri, në emër të Grupit Parlamentar “7+” Myfera Shinik, ndërsa në emër të Grupit Parlamentar SLS, Petar Miletiç, si dhe deputetët:

Arsim Bajrami, Nekibe Kelmendi, Nerxhivane Dauti, Riza Smaka, Gjylnaze Sylja, Armend Zemaj, Sabri Hamiti, Naim Rrustemi, Driton Tali, Bujar Dugolli, Gani Koci, Nekibe Kelmendi dhe ministri Haki Demolli, që janë dhënë në transkript, i cili është pjesë përbërëse e këtij procesverballi.

Pas këtyre diskutimeve, kryesuesi e hodhi në votim miratimin e këtij projektligji.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----62,

Kundër-----1,

Abstenime-----5.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi me shumicë votash e miratoi Projektligjin për gjykatat. Kuvendi ngarkoi Komisionin Komisionin për Legjislacion dhe Gjyqësi, si komision funksional dhe raportues, Komisionin për Buxhet dhe Financa, Komisionin për Komunitete dhe Komisionin për Integritet Evropian që ta shqyrtojnë këtë projektligj brenda dy muajve dhe Kuvendit t’ia paraqesin raportet me rekomandime.

6. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për grevat

Kryesuesi ftoi ministrin Mahir Yagcilar që në emër të Qeverisë ta prezantojë Projektligjin.

Ministri **Mahir Yagcilar** në fillim tha se e drejta për grevë është një e drejtë e cila garantohet edhe me Kushtetutën e Kosovës.

Në vazhdim tha se moszgjidhja e shumë çështjeve sociale mund të sjellë organizimin e grevave nga punëtorët, si një nga format e mundshme të deklarimit të tyre për këto çështje.

Projektligji rregullon çështjet që ndërlidhen me grevat, kushtet, organizimin dhe paralajmërimin e tyre, nga të punësuarit.

Në fund ai i ftoi deputetët për miratim në parim të Projektligjit për grevat.

Kryesuesi hapi debatin për shqyrtimin, në parim, të Projektligjit për grevat.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë projektligj dhanë këta deputetë: në emër të komisionit për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale, Sadik Idriz, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, Ramadan Avdiu, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Nurishahe Hulaj, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Gjylnaze Sylja, në emër të Grupit Parlamentar të AKR-së, Suzana Novoberdaliu, në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së, Qamile Morina, në emër të Grupit Parlamentar “7+”, Xhezair Murati, ndërsa në emër të Grupit Parlamentar SLS, Petar Miletiç, si dhe deputetët: Donika Kadaj – Bujupi, Riza Smaka, Mimoza Ahmetaj, Kaqusha Jashari, Emrush Xhemajli, Sanije Aliaj, Naser Rugova, Shkumbin Demaliaj, Nerxhivane Dauti, Bahri Hyseni, Fatmir Rexhepi, Sala Berisha – Shala, Berim Ramosaj, Naim Rrustemi dhe Driton Tali, që janë dhënë në transkript, i cili është pjesë përbërëse e këtij procesverbali.

Pas këtyre diskutimeve, kryesuesi e hodhi në votim miratimin e këtij projektligji.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----39,

Kundër-----14,

Abstenime-----6.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi e miratoi në parim, Projektligjin për grevat.

Kuvendi ngarkoi Komisionin për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale, si komision funksional dhe raportues, Komisionin për Legjislacion dhe Gjyqësi, Komisionin për Buxhet dhe Financa, Komisionin për Komunitete dhe Komisionin për Integritet Evropian që ta shqyrtojnë këtë projektligj brenda dy muajve dhe Kuvendit t’ia paraqesin raportet me rekomandime.

7. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për energjinë elektrike

Kryesuesi ftoi ministren Justina Shiroka-Pula që para deputetëve të prezantojë Projektligjin.

Ministria **Justina Shiroka-Pula** tha se Ligji në fuqi për energjinë elektrike ka disa vështirësi në procesin e zbatueshmërisë së plotë.

Në vazhdim tha se Projektligji për energjinë elektrike ka për qëllim të garantojë kushtet për prodhim, shpërndarje dhe furnizim me energji elektrike si dhe përpilimin e 4 rregullave të reja për organizimin dhe qasjen e transmisionit.

Në draftimin e këtij Projektligji kanë marrë pjesë edhe ekspertë nga KEK-u dhe nga operatorët e tjerë ashtu edhe ekspertë nga ministratë tjera të Qeverisë së Kosovës, tha ministria.

Ajo tha se Projektligji është në harmoni me direktivat e Bashkimit Evropian për energjinë elektrike.

Në fund ajo i ftoi deputetët për miratim në parim të Projektligjit për energjinë elektrike.

Kryesuesi hapi debatin për shqyrtimin, në parim, të Projektligjit për energjinë elektrike.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë projektligj dhanë këta deputetë: në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, Sala Berisha-Shala, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Zef Morina, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Haki Shatri, në emër të Grupit Parlamentar të AKR-së, Ibrahim Makolli, në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së, Naser Rugova, ndërsa “7+”, Zylfi Merxha, ndërsa në emër të Grupit Parlamentar SLS, Petar Miletiç, si dhe deputetët: Lulëzim Zeneli, Nerxhivane Dauti, Adem Hajdaraj, Driton Tali, Naim Rustemi, Bujar Dugolli dhe Fatmir Rexhepi që janë dhënë në transkript, i cili është pjesë përbërëse e këtij procesverbali.

Pas këtyre diskutimeve, kryesuesi e hodhi në votim miratimin e këtij projektligji. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----47,
Kundër-----8,
Abstenime-----4.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi miratoi Projektligjin për energjinë elektrike.

Kuvendi ngarkoi Komisionin për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport, dhe Telekomunikacion, si komision funksional dhe raportues, Komisionin për Legjislacion dhe Gjyqësi, Komisionin për Buxhet dhe Financa, Komisionin për Komunitete dhe Komisionin për Integritet Evropian që ta shqyrtojnë këtë projektligj brenda dy muajve dhe Kuvendit t’ia paraqesin raportet me rekomandime.

Pas kësaj pike të rendit të ditës, Kryetari pas pëlqimit të Kuvendit, konstatoi se për ditën e sotme seanca plenare përfundoi punimet, kurse vazhdimi i saj do të jetë me datë 16 prill 2010, e premte, në ora 10 :00.

Kryetari e deklaroi të mbyllur seancën në ora 18:35 minuta.

**E premte, 16 prill 2010, në ora 10,
Vazhdimi i seancës plenare të datës 15 prill 2010.**

Seancën e kryesoi **Jakup KRASNIQI**, kryetari i Kuvendit, ndërsa i ndihmoi **Naim Maloku**, anëtar i Kryesisë së Kuvendit.

Kryetari konstatoi se në sallë janë të pranishëm 64 deputetë.

Ai tha se në vazhdim të punimeve të seancës nga dita e djeshme, Kuvendi ka në radhë pikën nr. tetë të rendit të ditës:

8. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për shërbimet postare

Kryetari ftoi kryetarin e Komisionit për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion ose raportuesin e Komisionit që të arsyetojë amendamentet e propozuara.

Pasi nuk pati deputetë të paraqitur për diskutim për këtë pikë të rendit të ditës Kryetari i hodhi në votim një nga një, amendamentet e Komisionit për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion.

Kuvendi miratoi amendamentet: 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10, 11, 12, 13, 14, 15, 16, 17, 18, 19, 20, 21, 22 dhe 23.

Kryetari në vazhdim hodhi në votim tekstin e Projektligjit në tërësi, me amendamentet e miratuara

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----62,
Kundër-----1,
Abstenime-----2.

Kryetari konstatoi se Kuvendi, miratoi Ligjin për shërbimet postare.

9. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për Mërgatën e Kosovës

Kryetari ftoi kryetarin e Komisionit për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini dhe Sport ose raportuesin e Komisionit që të arsyetojë amendamentet e propozuara.

Pasi nuk pati deputetë të paraqitur për diskutim për këtë pikë të rendit të ditës Kryetari i hodhi në votim një nga një, amendamentet e Komisionit për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini dhe Sport.

Kuvendi miratoi amendamentet: 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9 dhe 10.

Kryetari në vazhdim hodhi në votim tekstin e Projektligjit në tërësi, me amendamentet e miratuara

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----59,
Kundër-----1,
Abstenime-----2.

Kryetari konstatoi se Kuvendi, miratoi Ligjin për Mërgatën e Kosovës.

10. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për tatimin mbi vlerën e shtuar

Kryetari tha se Komisionet parlamentare kanë shqyrtuar Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për tatimin mbi vlerën e shtuar dhe Kuvendit i kanë rekomanduar miratimin e tij pa ndryshime.

Kryetari ftoi kryetarin e Komisionit për Buxhet dhe Financa ose raportuesin e Komisionit që ta merr fjalën.

Gani Koci tha se plotësimet dhe ndryshimet në këtë Projektligj janë të propozuara nga Komisioni për Buxhet dhe Financa, dhe në emër të këtij komisioni i ftoi deputetët për ti votuar këto plotësim ndryshime të Projektligjit.

Pasi nuk pati deputetë tjerë të paraqitur për diskutim për këtë pikë të rendit të ditës Kryetari e hodhi në votim Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për tatimin mbi vlerën e shtuar.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----54,
Kundër-----7,
Abstenime-----5.

Kryetari konstatoi se Kuvendi, miratoi Ligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për tatimin mbi vlerën e shtuar.

11. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për zbatimin e sanksioneve ndërkombëtare

Para fillimit të votimit të amendamenteve, për fjalë u paraqit deputeti Ibrahim Gashi.

Ibrahim Gashi i njoftoi deputetët se nga 7 amendamente sa ka Projektligji, 4 nga këto amendamente janë të propozuara nga deputeti Riza Smaka, prej të cilave 1 amendament e ka pranuar komisioni funksional.

Pasi nuk pati deputetë tjerë të paraqitur për diskutim për këtë pikë të rendit të ditës Kryetari i hodhi në votim një nga një, amendamentet e propozuara..

Kuvendi miratoi amendamentet: 1, 2, 3, 4, 5 dhe 7.

Kryetari në vazhdim hodhi në votim tekstin e Projektligjit në tërësi, me amendamentet e miratuara

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----56,

Kundër-----4,

Abstenime-----1.

Kryetari konstatoi se Kuvendi, miratoi Ligjin për zbatimin e sanksioneve ndërkombëtare.

11. Shqyrtimi i Propozimit të Qeverisë së Kosovës për emërimin drejtorit dhe të zëvendës drejtorit të Zyrës së Rregullatorit për Ujësjiellës dhe Mbeturina

Kryetari ftoi kryetarin e Komisionit për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural dhe Planifikim Hapësinor ose raportuesin e Komisionit që të arsyetojë Raportin me rekomandime.

Naser Rugova tha se komisioni që ai drejton ka rekomanduar Kuvendin të shqyrtojë Propozimin e Qeverisë së Kosovës për emërimin drejtorit dhe të zëvendës drejtorit të Zyrës së Rregullatorit për Ujësjiellës dhe Mbeturina.

Për këtë pikë të rendit të ditës diskutoi deputeti, Ibrahim Makolli dhe Kryetari, Jakup Krasniqi, diskutime të cilat janë paraqitur në transkript, i cili është pjesë përbërëse e këtij procesverbali.

Pasi nuk pati deputetë tjerë të paraqitur për diskutim për këtë pikë të rendit të ditës Kryetari e hodhi në votim Propozimin e Qeverisë së Kosovës për emërimin drejtorit dhe të zëvendës drejtorit të Zyrës së Rregullatorit për Ujësjiellës dhe Mbeturina.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----57,

Kundër-----7,

Abstenime-----6.

Kryetari konstatoi se Kuvendi, mori këtë

V E N D I M

Për emërimin e drejtorit dhe zëvendës drejtorit të Zyrës së Rregullatorit për Ujësjiellës dhe Mbeturina

1. Raif Preteni, emërohet drejtor i Zyrës së Rregullatorit për Ujësjiellës dhe Mbeturina.

2. Kero Bardhi emërohet zëvendës drejtor i Zyrës së Rregullatorit për Ujësjellës dhe Mbeturina.
3. Mandati i të emëruarve nga pika një (1) dhe dy (2) e këtij vendimi zgjat pesë (5) vjet.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kuvendit.

13. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për formimin e Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e anëtarëve të Këshillit të Komisionit të Pavarur për Media

Kryetari ftoi për diskutim përfaqësuesit e grupeve parlamentare, komisioneve parlamentare dhe deputetët.

Pasi nuk pati deputetë të paraqitur për diskutim për këtë pikë të rendit të ditës, Kryetari e hodhi në votim Propozim-vendimin për formimin e Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e anëtarëve të Këshillit të Komisionit të Pavarur për Media.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----63,
Kundër-----2,
Abstenime-----3.

Kryetari konstatoi se Kuvendi, mori këtë

V E N D I M

- I. Formohet Komisioni Ad- hoc për përzgjedhjen e kandidatëve për anëtarë të Këshillit të Komisionit të Pavarur për Media në këtë përbërje:

1. Hajredin Hyseni nga PDK,
2. Ismet Beqiri nga LDK,
3. Esat Brajshori nga AKR,
4. Lulzim Zeneli nga LDD,
5. Ibrahim Selmanaj nga AAK,
6. Dragan Dimiq nga SLS,
7. Enis Kervan nga KDTP,
8. Dzezair Murati nga VAKAT,
9. Emrush Xhemjali nga LPK,
10. Kaqusha Jashari nga PSDK,
11. Edita Tahiri nga ADK,
12. Mark Krasniqi nga PSHDK,
13. Zef Morina nga PDKI,
14. Hafize Hajdini nga PDAK,
15. Zylfi Merxha nga PREBK,
16. Xhevdet Neziraj nga IRDK,

17. Branisllav Gerbiq nga ND,
18. Mursejl Halilji nga GIG,
19. Mihajlo Scepanoviq nga SNS, dhe
20. Numan Baliq nga SDA.

- II. Komisioni parlamentar Ad-Hoc, në bazë të nenit 4.3 të Ligjit për Komisionin e Pavarur për Media, duhet t'i shqyrtoi dhe t'i përzgjedh kandidaturat paraqitura për anëtar të Këshillit të Komisionit të Pavarur për Media.

14. Propozimet e Grupit Parlamentar të LDK-së dhe të Grupit Parlamentar të AAK-së për zëvendësimin e anëtarëve në komisionet parlamentare të Kuvendit

Pasi nuk pati deputetë të paraqitur për diskutim për këtë pikë të rendit të ditës, Kryetari kërkoi që Kuvendi të deklarohet me votim formal, me ngritje të dorës, për zëvendësimin e anëtarëve në komisionet parlamentare të Kuvendit.

Kuvendi me shumicë votash miratoi Propozimet e Grupit Parlamentar të LDK-së dhe të Grupit Parlamentar të AAK-së për zëvendësimin e anëtarëve në komisionet parlamentare të Kuvendit

Kryetari konstatoi se Kuvendi, mori këtë

V E N D I M

Për zëvendësimin e anëtarëve në komisionet parlamentare

- I.** Zëvendësohen anëtarët e komisioneve parlamentare nga grupi parlamentar i LDK-së, si vijon:
1. Deputeti Arsim Rexhepi emërohet kryetar i Komisionit për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini dhe Sport, në vend të ish deputetit Agim Veliu,
 2. Deputeti Adem Hajdaraj emërohet anëtar i Komisionit për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini dhe Sport, në vend të deputetit Arsim Rexhepi,
 3. Deputeti Naser Osmani emërohet anëtar në Komisionin për Mbikëqyrjen e Financave Publike, në vend të deputetit Arsim Rexhepi.
- II.** Zëvendësohen anëtarët e komisioneve parlamentare nga grupi parlamentar i AAK-së, si vijon:
1. Deputetin Shkumbin Demaliaj emërohet anëtar në Komisionin për Buxhet dhe Financa, në vend të deputetit Haki Shatri,
 2. Deputeti Ahmet Isufi emërohet anëtar në Komisionin për Administratë Publike, Pushtet Lokal dhe Media, në vend të ish deputetit Rasim Selmanaj,
 3. Deputeti deputeti Ibrahim Selmanaj për anëtar në Komisionin për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, në vend të deputetit Danush Ademi.

- III.** Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kuvendit.

Kryetari e deklaroi të mbyllur seancën plenare në orën 11:45 minuta.

Kryetari i Kuvendit,
Jakup KRASNIQI

Përgatiti: Divizioni për Çështje Plenare dhe Procedurale